



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 55**

**Datë: 28.11.2020. Ora: 11:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Artan Asllani, Rifat Krasniq.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.**

**Përkthyes: Argjina Misini**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.48/2020

- 2. Njoftim nga SKQZ, lidhur me përgatitjet për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut.**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të KVV-ve, sipas kërkesës së KKZ-së në Komunën e Podujevës.**
- 4. Shqyrtim i dhe miratimi i kufizimit të numrit të vëzhguesve në vendotim për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut.**
- 5. Të ndryshme.**

## **1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

**Valdete Daka:** Së pari ju uroj të gjithëve festën e 28 Nëntorit ! Tani, e hapi mbledhjen e 55-të. A ka dikush ndonjë vërejtje, propozim ? Nëse jo, kush është për këtë rend dite ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Në vazhdim të mbledhjes, u diskutua rreth procesverbalit nga mbledhja nr.48/2020, ku anëtari Sami Kurteshi, bëri vërejtje rreth fakti se ai nuk kishte qenë në këtë mbledhje prezent dhe se emri tij figuron, ndërsa pastaj, u analizua “pro et contra” çështja nëse, duhet vazhduar edhe më tutje me formatin e këtillë të pasqyrimin të zgjeruar të zbardhjes mbi bazën e stenogramit, apo ato duhet të jenë në formë të shkurtër – transkriptuese! ?

## **2. Njoftim nga SKQZ, lidhur me përgatitjet për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut:**

**Burim Ahmetaj:** Materiali zgjedhor është i përgatitur sipas planit operacional dhe materiali është dërguar, ne e kemi bërë verifikimin dhe konfirmimin me komisionet komunale! Nuk ju kemi sjellë me shkrim asgjë, mirëpo ne jemi siguruar tani se çdo gjë ka shkuar në rregull me shpërndarje të materialit, si në Podujevë dhe s’i në Mitrovicë. Nuk mungon asnjë material. Pra, jemi në rregull sot e kemi takimin me menaxherët e QV-e, pra do t’i diskutojmë të gjitha çështjet në mënyrë që nesër me mëngjes, të fillojmë mbajtjen e zgjedhjeve.

**Valdete Daka:** A ka filluar shpërndarja e materialit ?

**Burim Ahmetaj:** Shpërndarja deri në nivelin komunal është bërë prej KQZ-së, materiali është në rregull, dhe tani bëhet më tutje shpërndarja nga KKZ-të...!

**Valdete Daka:** Numrin e personave me covid, a e keni të konfirmuar i atyre që janë të interesuar me votue, apo...?

**Burim Ahmetaj:** Në komunën e Podujevës, janë kontaktuar të gjithë personat që duan të votojnë, dhe ata shtabi i ka kontaktuar. Kemi kërkuar që të kemi të dhëna edhe të atyre që janë në izolim, mirëpo rreth 200 persona që duan të votojnë përmes ekipeve mobile. Në komunën e Mitrovicës së veriut, i kemi 21 persona që zyrtarisht, kanë konfirmuar që do të votojnë përmes ekipeve mobile. Besojmë që gjatë ditës, do ta kemi numrin e saktë dhe, do t’ua përcjellim për të dy komunat...

**Alim Rama:** Për shkak se është ndryshuar procedura dhe, se nuk vulosen në librat e votimit, unë kisha sugjeruar që Sekretariati edhe sot t’i kontaktojë se ka kohë se, edhe ashtu votojnë me kusht... Pra, t’u japim të gjithëve me votuar, se tash nuk vulosen...

**Burim Ahmetaj:** Sekretariati, do t’ua japë të gjithëve mundësinë, pra do të japim informacion mbi këtë...

### **3.Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimeve të KVV-ve, sipas kërkesës së KKZ-së në Komunën e Podujevës.**

**Valdete Daka:** I kemi emrat...! Këta janë që janë lajmëruar që nuk mundën me marrë pjesë, prandaj kush është për zëvendësim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan zëvendësimin e 6 anëtarëve të KVV-së, sipas kërkesës së KKZ-së në Komunën e Podujevës.

### **4.Shqyrtim i dhe miratimi i kufizimit të numrit të vëzhguesve në vendvotim për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut.**

**Valdete Daka:** Jemi dakorduar dje që ta shqyrtojmë këtë çështje, pra të shohim, mos t'ua lëmë këtë të drejtë KKZ-ve sepse, më mirë është që ne të vendosim dhe jo t'ua lëmë tash atyre për shkak se, mund të shkaktohen probleme, mosmarrëveshje etj. Unë kisha propozuar që të jenë nga 1 vëzhgues nga subjektet politike, me kusht që ata të ndërrohen, ta zëmë deri në ora 12: 00...Pra, rri njëri, dhe pastaj vjen tjetri...!

Nëse pajtoheni, pra e kemi vendimin dhe e shpërndajmë te të gjithë ata që duhet: subjektet, organizatat, KKZ –të...!

**Eshref Vishi:** Sa është numri në total ?

**Valdete Daka:** Po, është 1665...

Në debat të gjatë, e të analizuar me detaje, morën pjesë: Eshref Vishi, Sami Hamiti, Yll Buleshkaj (ZRPP), Arianit Elshani, Valdete Daka, Alim Rama, Sami Kurteshi dhe Burim Ahmetaj ( Sekretariati).

Anëtarët e KQZ-së, në fund u dakorduan për kufizimin e numrit të vëzhguesve në vendvotim për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicës së veriut.

### **5.Të ndryshme !**

